



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:126285

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06011895

KF.nr.572/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me procesmbajtësen Arlinda Hyseni në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “A.Z.” B.I me seli në Pejë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 30.07.2024, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. HEDHET POSHTË padia me numër KF. nr.572/22 e datës 20.06.2022, e paditësit “A.Z.” B.I me seli në Pejë, e ushtruar kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë si e paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

**A r s y e t i m**

Paditësi ka ushtruar padi me datën 20.06.2022 duke kërkuar anulim e vendimit nr.169/2022 të datës 21.04.2022, me objekt kontesti vlerësim tatimor, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 04.11.2022, kundërshton në tërësi pretendimet e paditësit si të pa bazuara, duke theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilin pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetim se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një

provë të vetme, duke i propozuar gjykatës që ta hedhë poshtë padinë për faktin se padia është paraqitur pas kalimit të afatit.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ komfor dispozitës së nenit 41 të LKA-së, për arsye se në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.07.2024 nuk kanë prezantuar askush nga palët ndërgjyqëse edhe pse të njëjtit e kanë pranuar ftesën për këtë seancë në mënyrë të rregullt. Padiësi e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datën 12.07.2024, ndërsa nuk e ka arsyetuar mungesës-mospjesëmarrjen. Po ashtu edhe e paditura ftesën për këtë seancë e ka pranuar me datën 10.07.2024, ndërsa nuk e ka arsyetuar mungesës-mospjesëmarrjen.

Gjykata në këtë seancë dhe pas shqyrtimit të padisë së padiësit të parashtruar të datës 20.06.2022, dhe shkresave tjera të lëndës, respektivisht vendimin kontestues nr.169/2022 të datës 21.04.2022, ka bërë përlllogaritjen e ditëve kalendarike, dhe ka konstatuar se nuk mund të veprohet sipas kërkesëpadisë së parashtruar me padi, pasi që siç u theksua më lartë padia e padiësit është paraqitur me datën 20.06.2022 fakt ky i cili vërtetohet vula pranuese në gjykatë, ndërsa vendimi kontestues nr.169/2022 i datës 21.04.2022 është pranuar nga pala padiëse me datën 18.05.2022, fakt ky i cili vërtetohet nga flet kthesa e ATK-së, andaj nga dita e pranimit të vendimit kontestues 18.05.2022 e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë me datën 20.06.2022, kanë kaluar më shumë se 30 ditë, andaj gjykata vlerëson se padia e padiësit në këtë rast është e pas-afatshme, andaj bazuar në të gjitha këto si më lartë kjo Gjykatë nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të padiës së padiësit, në kuptim të nenit 34 par.1 pika 1.1, të LKA-së.

Në nenin 34 par.1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative është parashikuar shprehimisht se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme”*.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Për arsyet e mësipërme, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 34, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.572/22, datë 30.07.2024

Gj y q t a r i  
Fisnik NULI

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.